

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tragjedi në Romë, prindërit vrasin vajzën e tyre 5-vjeçare me aftësi të kufizuar e më pas veten, letrat tro nditëse që lanë pas – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/tragjedi-ne-rome-prinderit-vrasin-vajzen-e-tyre-5-vjecare-me-a-ftesi-te-kufizuar-e-me-pas-veten-letrat-tronditese-qe-lane-pas/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:48:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 07:41:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6817f40d6c86c5cfad3701bf5764228501149953f82d844a7b2b2727f45709b1
TEKSTI	9adcc73fd7837f80eda92ef8f127b74425284f80657eecac1529276ae5b734f1
PAMJA	6ae990fa3b0b26546fcfea3a071de1761ad708c04c53f881775c452e1782ef1e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4fcc1efe3a1d273b77fb10683305d854cc3b149cddc64e8336dd6677b3d82cad
E MËPARSHMJA	b1c605c635ba7072b8fe8f6afadf390d94b383371066a11d6175b2b215dd97a8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4fcc1efe3a1d273b77fb10683305d854cc3b149cddc64e8336dd6677b3d82cad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Një ngjarje e rëndë ka tronditur lagjen Pietralata në Romë, ku tre anëtarë të një familjeje u gjetën të pajetë në dhomën e gjumit të banesës së tyre. Viktimat janë Luca Abbasciano, 42 vjeç, bashkëshortja e tij Valentina Pambianco, 41 vjeçe, dhe vajza e tyre 5-vjeçare, Bianca, e cila kishte një aftësi të kufizuar të rëndë. Edhe qeni i familjes u gjet i pajetë, me plagë të shaktuara nga arma e zjarrit.

Alarmi u dha rreth orës 13:00 të së hënës, më 31 gusht, pasi një familjar nuk po arrinte të kontaktonte me ta. Shërbimet e emergjencës mbërritën në banesën në Via dell'Antracite dhe, pasi hapën me forcë derën, u përballën me skenën tragjike. Në vendngjarje u gjet edhe një pistoletë, e cila rezulton të ishte e regjistruar dhe në posedim të 42-vjeçarit.

Hetuesit po ndjekin kryesisht pistën e një vrasjeje-vetëvrasjeje, por dinamika e saktë ende nuk është përcaktuar. Testi kriminalistik i njohur si "Stub" pritet të ndihmojë në përcaktimin se kush e ka përdorur armën. Në banesë u gjetën edhe rreth një duzinë letrash, të nënshkruara nga të dy bashkëshortët dhe të drejtuara familjarëve, ku shprehej mesazhi se "vetëm nuk ia dalim dot".

Sipas rindërtimit paraprak, çifti kishte përballuar prej vitesh vështirësi të mëdha në kujdesin ndaj vajzës së tyre, e cila kishte lindur para kohe dhe me probleme të rënda shëndetësore. Familja ishte e njohur dhe ndiqej nga shërbimet sociale të bashkisë, përfshirë edhe mbështetje ekonomike. Megjithatë, autoritetet theksojnë se bëhej fjalë për një familje të integruar dhe jo për një situatë marginalizimi.

5 "Dhembja e pjekurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Kryetari i Bashkisë IV të Romës, Massimiliano Umberti, shprehu dhimbje të thellë për tragjedinë, duke thënë se familja kishte luftuar prej vitesh për të përballuar situatën dhe se ndihma e ofruar nga institucionet, pavarësisht përpjekjeve, nuk kishte rezultuar e mjaftueshme. Hetimet vijnë për të zbardhur plotësisht rrethanat dhe orët e fundit të familjes.

/vizionplus.tv

#Rome

#Tragjedi

#vrasinvajzen



Ana Miha

Gazetarje · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Tragjedi! Përmyset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku

5 orë më parë



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...

Xhuljana Zhuleku

Dje 19:36



BOTA

Trump: Lufta me Iranin do të...

Xhuljana Zhuleku

Dje 18:51



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.